



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKË
KONTRATË

14.07.2020

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKË REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUHAREKA REPUBLIC OF KOSOVO - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NE DOREZIM		PRIMLJENO RECEIVED	
Nësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Braj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	351	29456	7

KOMUNA SUHAREKË, të cilën e përfaqëson Mustafë Buzhala, zyrtar i zyrës së Prokurimit dhe menaxheri i kontratës i caktuar me Aktvendim nga ZKA ne PMK ¹ (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik AM GROUP SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Mirusha Company Sh.p.k; N.N.SH.ARD, BRIGADA 123, 23000, SUHAREKË. me seli ne Suharekë me NRB: 811320910 të cilën e përfaqëson Abedin Maliqaj (ne vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për punët e shënuara me poshtë:

Titulli i kontratës

Asfaltimi i rruges që lidhë fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi)-Lagjja Zekolli) ,Suharekë
Nr i prokurimit 624-19-074-521 / 624-19-6384-5-1-1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lëndë e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit: **Asfaltimi i rruges që lidhë fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi)-Lagjja Zekolli) ,Suharekë ,sipas** specifikimeve teknike te dosjes se tenderit. Kjo kontratë eshte lidhur në bazë të Marëveshjes Nr.02 .2396, datë 08.03.2019 në mes të Komunës Suharekë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit.
- 1.2 Punët duhet të përfundojnë sipas dinamikës së përcaktuar nga njësia e kërkesës, me se largu brenda 300 ditë pune dhe sipas dinamikës se përcaktuar nga menaxheri i projektit ne PMK.
- 1.3 Operatori ekonomik para nënshkrimit te kontratës duhet të sjell sigurimin e ekzekutimit 10% të vlerës së kontratës per nje periudhe prej: 330 ditësh.
- 1.4 E.O është i obliguar te bashkëpunoj me menagjerin e kontratës te Autoritetit Kontraktues dhe zyren e prokurimit. OE është i obliguar të njoftoj zyrën e prokurimit dhe menagjerin e projektit, nëse projekti kapital nuk është duke u realizuar konformë kontratës dhe specifikimeve dhe paramanave të dhëna me kontratë.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 577.201,73 euro (pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë euro e dyqind e një euro e shtatëdhjetë e tre cent).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

2.4 Autoriteti Kontraktues ne bazë të mareveshjes me MIT, do të bëjë pagesën në euro, sipas faturave te dorëzuara së bashku me raportin e nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe menaxheri i kontratës, në llogarinë bankare të OE.

2.5 Pagesa e fundit në vlerë jo më pak se 10% vlerës së kontratës do të bëhet me raportin e mbikëqyrësit dhe menaxherit të projektit te projektit.

¹ PMK Plani Menaxhimit te Kontrates

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës së vendit)
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4**Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.


4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

4.5 Numri kontaktues i OE është 049 – 600-751

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Mustafë Buzhala
Pozita:	Zyrtar i zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	14.07.2019
Vula	vv

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Abedin Maliqaj
Pozita:	Përfaqësues
Nënshkrimi	
Data:	14.07.2019
Vula	vv

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Bali MUHARREMAJ
Pozita:	ZKA/Krytar i Komunës
Nënshkrimi:	
Data:	14.07.2019
Vula	vv

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Asfaltimi I rruges që lidhë fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi)-Lagjja Zekolli),Suharekë Nr i prokurimit 624-19-074-521 / 624-19-6384-5-1-1
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës se kontratës me vlefshmëri prej 330 ditësh.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i

		pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 3 ditë nga data e pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 3 dite pas nenshkrimit te kontrates, nese nuk specifikohet ndryshe ne PKM.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 330 ditë kalendarike dhe nese palet pajtohen munde ta rregullojne dinamiken me PMK.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: Menaxheri i caktuar me vendim te ZKA nga DSHPE
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës (me sigurim ekzekutimi).
Vërtetimet e pagesë	28	28.1 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

		28.2. Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë pas pranimit teknik.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	ZP Komuna Suhareke ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Nr i prokurimit 624-19-074-521&624-19-6384-5-2-1 Asfaltimi I rruges që lidhë fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi)-Lagjia Zekolli), Suharekë

Për:	ZYREN E PROKURIMIT KOMUNA SUHAREKË
Nga:	Grup i Operatorëve Ekonomik AM GROUP SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K.; Mirusha Company Sh.p.k; N.N.SH.ARD, BRIGADA 123, 23000, SUHAREKË
Lënda:	DEKLARATË PER KUALITETIN E PUNIMEVE
Datë:	14.07.2020

I/e nderuar,

Kjo deklaratë bëhet në pajtim me Kontratën:

Titulli i kontratës

Asfaltimi I rruges që lidhë fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi)-Lagjia Zekolli), Suharekë
Nr i prokurimit 624-19-074-521 / 624-19-6384-5-1-1

Për të përmbushur obligimet që dalin nga neni 27 pika 1 dhe 34.5 (KVK) e kontratës së lartcekur.

Ne konfirmojmë se:

Ne si Operator Ekonomik pas pranimit teknik ofrojmë garancion të rregullt 1 vjeçar, duke siguruar garancion prej 10 % nga vlera e kontratës, si dhe deklarojmë mbi cilësinë e punës dhe mallrave në kohëzgjatje 1 vjet nga dita e pranimit teknik dhe obligohemi dhe pranojmë se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do t'i sanojmë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të kundërtën ne pajtohemi se AK ato dëme do t'i sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do të na faturojë ne si Kontraktor që kemi dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve.

Me respekt:

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit: ABEDIN MALIQAJ Nënshkrimi Amaligaj

DATA: 14.07.2020



Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

PARAMASA DHE PARALLOGARIA PROJEKTUESE


Objekti: Asfaltimi i rrugës që lidhë fshatin Ngucat (Rruga Bashkim Gashi) - (Lagja Zekolli), Suharekë

I	Punët pregaditore	Njesia	sasia	Çmimi	shuma
I.1	Shenimi i trases së rrugës sipas projektit (bartja e shenimeve nga projekti në terren).	m'	2,613.06	0.10	261.31
I.2	Pastrimi i terenit nga vegjetacioni, prerja e drunjeve dhe largimi i tyre.	m'	2,613.06	0.20	522.61
Gjithesëjt=					783.92

II.	Punët e dheut	Njesia	sasia	Çmimi	shuma
II.1	Mihja e dheut të kat. III-IV si dhe transporti deri në deponi në largësi 3 km.	m³	28,600.00	0.20	5,720.00
II.2	Planifikimi dhe ngjeshja (kompaktimi) i nënbazës me cilindër vibrues me peshe mbi 7.5 ton deri në Ms-400kg/cm²	m²	19,597.95	0.10	1,959.80
II.3	Punimi i mbushjes me material stabilizues, në qmim të kalkulohet (furnizimi, transporti, planifikimi dhe ngjeshja në shtresë t=30 cm me vibrocilindër 12t. Deri në Ms-400 kg/cm²	m³	11,460.00	1.00	11,460.00
II.4	Hapja e kanaleve anësore për largimin e ujrave atmosferike kat. III dhe IV sipas detalit të dhanun në projekt dhe dhenja e formës së rregullt gjeometrike në formë trapezi.	m'	5,226.12	0.30	1,567.84
Gjithesëjt=					20,707.63

III.	Objektet	njesia	sasia	qmimi	shuma
III.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të betonit të armuar me koka hyrese dhe dalese Ø 1000 sipas detalit të dhanun në projekt. Në qmim është kalkuluar hapja e kanalit dhe shtresa e betonit nën dhe mbi gypë.	m'	60.00	55.00	3,300.00
III.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të betonit të armuar me koka hyrese dhe dalese Ø 800 sipas detalit të dhanun në projekt. Në qmim është kalkuluar hapja e kanalit dhe shtresa e betonit nën dhe mbi gypë.	m'	120.00	45.00	5,400.00
Gjithesëjt=					8,700.00


IV	Mbistruktura e rrugës	Njesia	sasia	Çmimi	shuma
IV.1	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe kompaktimi i shtresës së tamponit me material të granulluar 0-60 mm. në trashësi t=30 cm Ms-800 kg/cm²	m³	5,800.00	1.00	5,800.00
IV.2	Furnizimi, transporti, planifikimi dhe kompaktimi i shtresës së tamponit me material të granulluar 0-31 mm. i cimentuar në trashësi t=20 cm. Ms-1000 kg/cm²	m³	3,900.00	3.00	11,700.00
IV.3	Punimi i bankinave në të dy anët e rrugës me material vendor - guror stabilizues në gjersi 1.5 m dhe trashësi t=15 cm.	m²	1,959.80	2.00	3,919.59
IV.4	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës konglomerat 0-22 mm (zhavor I bitumenizuar) t=9 cm	m²	15,991.93	12.00	191,903.16



IV.5	Furnizimi ,transporti dhe punimi i shtreses asfalt betoni d=5 cm (fraksion zhavori 0.11 mm)	m ²	15,991.93	13.00	207,895.09
Gjithesëjt=					421,217.84

V.	SINJALIZIMI VERTIKAL DHE HORIZONTAL	njesia	sasia	qmimi	shuma
V.1	Furnizimi dhe realizimi i vijes ndarese te shiritave te qarkullimit dhe vijave kufizuese te rruges b=15cm (perfshihet shiriti I mesit dhe aneve te rruges).	m'	7,839.18	0.80	6,271.34 €
V.2	Furnizimi,vendosja dhe instalimi i udherrefysve te rruges.	copë	200.00	15.00	3,000.00 €
V.3	Furnizimi,instalimi dhe perforcimi i shenjave rrugore	cope	65.00	20.00	1,300.00 €
V.4	furnizimi dhe vendosja e pahive elastike me trashesi te murit b=4mm tip B " ne qmim te kalkulohen edhe shtyllat per perforecim qdo 4m dhe retroreflektuesit qdo 4 m	m'	3,080.00	20.00	61,600.00 €

IV	PUNËT NDËRTIMORE TË URËS METALIKE	njesia	sasia	qmimi	shuma
VI.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes për punë si dhe largimi i instalimeve ne punishte në rast se ka në ato hapësira.	cope	1.00	150.00	150.00
VI.2	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në urës.	cope	1.00	50.00	50.00
VI.3	Shenimi i matjeve të urës para fillimit të punimeve dhe gjatë ekzekutimit.	cope	1.00	50.00	50.00
VI.4	Pastrimi i terenit ku do të ndërtohet ura betonarme, largimi i mbetorinave të hedhura nga qytetaret, si dhe ngarkimi, transporti në deponin legale.	cope	1.00	150.00	150.00
VI.5	Germimi i dheut të kategoris së II-të dhe IV-të me makin për hapjen e themeleve, mureve mbajtse të urës. Si dhe largimi i dheut në deponin legale.	m ³	610.00	1.00	610.00
VI.6	Furnizimi, bartja dhe shtrurja e bazamentit të themeleve dhe shtratit nënë urë me zhavor (gur i thyer frak.0-120mm) me trashsi t=1.0m duke ngjeshur në shtresa deri sa te arrihet moduli ngjeshmëris (40MPa).	m ³	243.00	2.00	486.00
VI.7	Furnizimi, bartja dhe mbushja me zhavorit (gur i thyer frak.0-64mm) rreth mureve mbajtse beton arme të urës, duke e ngjeshur në shtresa.	m ³	280.00	3.00	840.00
VI.8	Furnizimi, betonimi i themelit pllakë dhe të vequara të urës me trashsi t=100cm nga betoni i armuar C 30/37. Në llogari të merret edhe pahia e nevojshme. Llogarimi në m ³ të betonit të vendosur.	m ³	120.00	80.00	9,600.00
VI.9	Furnizimi, betonimi i pllakës të shtratit të lumit me trashësi t=30cm nga betoni i armuar C- 30/37. Ne qmim te kalkulohet edhe armatura mbajtse në dy zonat RØ12mm (15x15) cm. Llogarimi ne m ³ të pllakës së punuar.Në llogari te merret edhe pahia e nevojshme.	m ³	50.00	80.00	4,000.00



VI.10	Furnizimi, montimi dhe saldimi trajeve kryesore dhe terhoire konstruksion metalik. Në qmim të kalkulohet te gjitha punet percjellese , bulona shtangues angerat lyerja dhe punet tjera percjellese	kg	15350.00	0.70	10,745.00	✓
VI.11	Furnizimi, betonimi i mureve nga betoni dhe shtyllave pjesërisht të integruara në muret mbajtse, si dhe krihve ansor nga betoni i armuar C-30/37, me pahi dhe skele të nevojshme. Llogarimi ne m3 te betonit te vendosur.	m³	95.00	80.00	7,600.00	✓
VI.12	Furnizimi ,betonimi i pllakave kalues të urave me trashesi t= 50cm /shiko projektin/ nga betoni i armuar C 30/37, me pahi dhe skele të nevojshme. Llogaria te bëhet per m3 te pllakes se punuar.	m³	65.00	80.00	5,200.00	✓
VI.13	Furnizimi ,betonimi i pllakave kapërcyese të urës me trashesi t=25cm /shiko projektin/ nga betoni i armuar C 30/37. Ne qmim te kalkulohet edhe armatura mbajtse në dy zonat RØ12mm (15x15) cm, me pahi dhe skele të nevojshme. Llogaria te bëhet per m³ te pllakes se punuar.	m³	10.50	80.00	840.00	✓
VI.14	Largimi i ujit të lumit me dy renda gypa betoni Ø1000 mm, me gjatsi të mjaftushme për zhvillimin e punimeve dhe pompë elektrike për largimin e ujit gjatë gjith kohës se punimeve në urë.	cope	1.00	50.00	50.00	✓
VI.15	Punimi dhe vendosja e gardhit të urës në të dy anët . Punimi i gardhit te rampes behet prej tubave te qelikut me ø 60.3 mm në qdo 2.40m dhe dy zonave lartë dhe posht ndërsa mbushjet me profil të mbushur-plotë ø 30mm dhe lartesi te gardhit prej h= 110 cm (shiqo projektin). Të njejtë të ngjyrosen me ngjyre baze dhe dy shtresa ngjyre yndyrore. Duke llogaritur edhe liadhjen me beton. Llogari ne m' te gardhit te punuar.	m'	50.00	5.00	250.00	✓
VI.16	Punimi dhe montimi i armaturës sipas logaris statike nga profilet dhe kualiti S 500 H për të gjitha pozicionet duke ju referuar skemave statike. Llogaria në kg të armaturës së vendosur në punë.	kg	20,000.00	0.65	13,000.00	✓
REKAPITULIMI			Gjithesejt=		53,621.00	✓

Nr	Pershkrimi i Puneve	Gjithsejt Vlera (euro)
I.	Punet pregaditore	783.92 €
II.	Punet e dheut	20,707.63 €
III.	Objektet	8,700.00 €
IV.	Mbistruktura e rruges	421,217.84 €
V.	SINJALIZIMI VERTIKAL DHE HORIZONTAL	72,171.34 €
VI.	PUNËT NDËRTIMORE TË URËS METALIKE	53,621.00 €
X	Total	577,201.73 €

DORËZUAR NGA:

EMRI I KOMPANISE	IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK
------------------	------------------------------------



ADRESA E PLOTE	
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	
POZITA	
NENSHKRIMI	
DATA	
VULA	